



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1039_10_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 31.10.2013.

në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.Q., (shifra e konsumatorit DPE - 9045690) nga Peja ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1039_10_13 i datës 08.10.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për pranimin e instalimit të njehsorit elektrik me datë 28.12.2012 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 17733683 me gjendje: TL=2660 kW (tarifa e lartë) dhe TU=1861 kW (tarifa e ulët).

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 03.02.2013 ka dërguar tek konsumatori me shifër DPE - 9045690 faturën e energjisë elektrike për periudhën e muajit janar 2013, me shpenzim prej 5440 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 488.08 €.

Konsumatori pas kësaj me datë 17.02.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit janar 2013.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 01.03.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, dhe listat e leximit.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 08.10.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1). të shkarkon konsumatorin nga fatura 01130DPE-9045690 e datës 03.02.2013 në vlerë prej 488.08€; 2) Për muajin janar 2013 ta faturon konsumatorin me diferencën e shpenzimit mes gjendjes së lexuar në muajin janar 2013 dhe atë regjistrimit të njehsorit elektrik të datës 28.12.2012: TL=500 kWh dhe TU=424 kWh; dhe 3) diferencën e shpenzimit të krijuar në njehsorin elektrik nr. 17733683 në mes të procesverbalit të pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr. 102993 të datës



28.12.2012 (DPR – 9045690) dhe asaj të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të shifrës DPE – 125830 ta kërkoj përmes procedurës gjyqësore.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 31.10.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe ka theksuar se aprovohet pjesërisht vendimi i juaj ashtu që duhet të bëhet shpërndarja për dy muaj, prej 12/2012 – 01/2013 në vlerë prej (-20.88€).

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se nuk ka bazë për korrigjim ngase procesverbali nr. 102993 qartë e specifikon se me datë 28.12.2012 është bërë pranimi i kërkesës së datës së 17.12.2012 për lidhje të re. Në ankesë theksohet se nuk ka kurrfarë dyshimi se KEDS-i nuk ka vepruar sipas procedurave për pranimin e instalimit dhe se korrigjimi i faturës së janarit është bërë duke bërë shpërndarjen për dy muaj (12/2012 – 01/2013). Në ankesë theksohet se pranimi i njehsorit elektrik me kilovat të shpenzuar nuk është dashur të pranohet nuk qëndron ngase në asnjë procedurë nuk e specifikon këtë, dhe se duhet të lirohet nga taksa e paguar (lidhje e re). Po ashtu theksohet se shpenzimi duhet të rrjedhë pas shpenzimit të gjetur në njehsor dhe se nuk obligohet që të paguaj borxhin e tjetër kujt atëherë shtrohet pyetja se kujt i paska qenë ky borxh i energjisë elektrike në njehsorin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pretendimet e KKDFE-së se sipas procesverbalit nr. 102993 të datës 28.12.2012 është bërë pranimi i kërkesës për lidhje të re, nuk qëndron pasi që në procesverbalin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik vërehet se kemi regjistrim të njehsorit elektrik nr. 17733683 nga ana e KEK-ut me gjendje TL=2660 kW dhe TU=1861 kW, dhe se sipas kësaj duke pasur parasysh se kjo ka qenë lidhje e re, atëherë gjendja e kilovatëve në njehsorin elektrik do të duhej të ishte zero dhe jo me shpenzim, përveç në ato raste kur kemi kyçje të mëhershme dhe ajo do të ishte kyçje ilegale dhe trajtohet si shfrytëzim i paautorizuar, e që për të cilën nuk kemi informatë se KEK-u ka filluar ndonjë procedurë të tillë.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se pranimi i njehsorit elektrik si instalim i ri me kilovat të shpenzuar nuk është dashur të pranohet por me gjendje zero nuk qëndron ngase asnjë procedurë nuk e specifikon këtë, duhet theksuar se sipas nenit 32 të Ligjit për Energjinë Elektrike, pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë, pra që në rastin konkret sipas këtij neni pronar i pikës matëse është Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të Furnizimit me energji janë të specifikuara dispozitat ligjore rreth procedimit të konsumatorëve për kyçje të re, nga parashtrimi i kërkesës, shqyrtimi i kërkesës/aplikacioni për kyçje të re, oferta me shkrim e ndërmarrjes, marrëveshja për kyçje dhe deri te kontrata për furnizim me energji elektrike. Po ashtu duhet theksuar se në rastet kur kemi shpenzim të regjistruar në njehsor dhe është bërë kërkesa për lidhje të re, atëherë KEK-u ka mundur të fillojë procedurë si shpenzim i paautorizuar i cili ka qenë ilegal dhe kjo është theksuar se vendimin e DMK-së.

Sa i përket pretendimit se KEDS-i nuk mundet t'i ruajë shifrën për 9 vite dhe se njehsori elektrik nr. 17733683 është pasivizuar pas muajit 01/2004 me zero obligime, duhet theksuar sipas dokumentacionit të siguruar nga KEDS-i njehsori elektrik nr. 17733683 ka qenë pronë e KEK-ut dhe se ky njehsor elektrik ka qenë i regjistruar në shifrën DPE – 125830 në emër të M.Q. dhe se pas periudhës 01/2004 është pasivizuar ky njehsor elektrik edhe pse nuk ka procesverbal të pasivizimit të këtij njehsori apo të kësaj shifre. Po ashtu duhet theksuar se në periudhën 01/2004 gjendja e njehsorit elektrik ka qenë TL=5 kWh dhe TU=3 kWh, ndërsa në momentin e regjistrimit të njehsorit elektrik nga ana e KEK-ut ka qenë: TL=2660 kWh dhe TU=1861 kWh, gjë që sipas kësaj vërehet se nga



periudha 01/2004 – 12/2012 kemi një krijim të shpenzimit prej TL=2655 kWh dhe TU=1858 kWh, e që nuk vërtetohet se kush e ka shpenzuar atë energji elektrike. Andaj KEK-u pas kërkesës së konsumatorit për lidhje të re të bënë verifikimin se a ka ekzistuar ky njehsor elektrik në ndonjë shifër apo jo dhe t'i jep konsumatorit me shkrim shqyrtimet e kërkesës.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1039_10_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar